



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DURRËS  
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 63, datë 25.06.2024

**PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË RINDËRTIMIT PËR VITIN 2024  
AKORDUAR NË FORMËN E TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR PËR FINANÇIMIN  
E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESEA PALLAT DHE NJËSI  
INDIVIDUALE, DHE RINDËRTIMIN E BANESAVE INDIVIDUALE, DURRËS**

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 5.6.2024 “Për disa shtesa në vendimin nr. 167, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rrogozhinë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 5.6.2024 “Për disa shtesa në vendimin nr. 503, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 5.6.2024 “Për një shtesë në vendimin nr. 255, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Durrës”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 359, datë 5.6.2024 “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit”, Udhëzimit nr.22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të

monitorimit të buxhetit të njërive të vetëqeverisjes vendor”, të Udhëzimit Plotësues të Ministrisë të Financave nr.1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2024”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Të miratojë përdorimin e fondeve të rindërtimit, të alokuara në formën e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2024, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 5.6.2024 “Për disa shtesa në vendimin nr. 167, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë, Kamzë dhe Rogozhinë”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 347, datë 5.6.2024 “Për disa shtesa në vendimin nr. 503, datë 27.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të banesave individuale në bashkitë Durrës, Vorë dhe Shijak”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 349, datë 5.6.2024 “Për një shtesë në vendimin nr. 255, datë 29.4.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rirforcimit të njërive individuale të banimit dhe njërive të banimit në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Durrës”, të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 359, datë 5.6.2024 “Për një shtesë dhe një ndryshim në vendimin nr. 181, datë 30.3.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rirforcimit të njërive individuale të banimit dhe njërive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë”, të ndryshuar, sipas tabelës si më poshtë vijon:



VKM që ka alokuar fondin për pjesën e mbetur	Emërtimi i Projektit	Kodi i programit	Llograia Ekonomike	Kodi Produktit	Fondi për vitin 2024
VKM Nr.359, datë 05.06.2024 VKM Nr.349, datë 05.06.2024	Riforcimi njërive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njërive individuale të banimit	04960	231	94902AB	453,051,582
VKM Nr.338, datë 05.06.2024 VKM Nr.347, datë 05.06.2024	Rindërtim i banesave individuale (grante)	04960	606	94902AC	257,431,652
<b>TOTALI</b>					<b>710,483,234</b>

2. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 26.06.2024**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS



Nr. 389/prot.

Durrës, më 01.07.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË  
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.63 datë 25.06.2024 “Për miratimin e përdorimit të fondeve të rindërtimit për vitin 2024 akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa pallat dhe njësi individuale, dhe rindërtimin e banesave individuale, Durrës”,

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI**

**EMILJAN JANI**

